



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës - Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 197/26 Dt. 04.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejin e furnizimit me goma verore dhe dimërore për automjetet zyrtare të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor- mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Administratës dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 200/26 Dt. 04.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës për lejimin e furnizimit me pelet për ngrohje qendrore për nevojat e Komunës së Prizrenit, si dhe furnizim me dru për ngrohje për nevojat e zyrave të Gjendjes Civile (zyrat e vendit), etj., kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor- mallra dhe shërbime të Drejtorisë së Administratës dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 198/26 Dt. 04.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi


Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-564, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formim të Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për mbikëqyrjen, kontrollimin dhe monitorimin e faturave sipas kontratës me nr. të prokurimit 622-25-4682-2-2-1 për ofrimin e shërbimeve ligjore për nevojat e Komunës së Prizrenit. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen si në vijim:
 - 1.1. Vlora Isufi -Xhoxhaj.....menaxhere e kontratës,
 - 1.2. Adonita Karavidaj.....zyrtare ligjore,
 - 1.3. Loreta Spaqi-Çollaku.....zyrtare për administratë dhe shpenzime.
2. Detyrat e Komisionit do të jenë: të bëjë mbikëqyrjen, kontrollimin dhe monitorimin e faturave sipas kontratës me nr. të prokurimit 622-25-4682-2-2-1 për ofrimin e shërbimeve ligjore për nevojat e Komunës së Prizrenit, të lidhur ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe “Zyrës së Avokatisë Blerim Mazreku” SHPK; Naim Cahani B.I” nga Prizrenit, si dhe, pas vlerësimit përmes procesverbalit dhe akteve tjera ligjore të konstatojë gjendjen faktike të tyre.
3. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t’i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Administratës dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Të emëruarve,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 199/26 Dt. 04.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e realizimit të projektit: “Shitja e automjeteve të klasifikuara të pa përdorura”, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e ankandit publik.
2. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 196/26 Dt. 04.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MASHT) 02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e udhëtimit zyrtar të Haxhere Gavazaj dhe Nexhat Maçkaj -zyrtarë komunal të DKA-së në Komunën e Prizrenit, nga data 05 maj 2026 deri 07 maj 2026, me qëllim të vizitës së nxënësve maturan të cilët ndodhen në ekskursion në Durrës të Republikës së Shqipërisë. Shkollat (nxënësit maturan të cilët ndodhen në ekskursion janë nga: SHMLM "Luciano Motroni" së bashku me shkollën e muzikës, Gjinnazi "Gjon Buzuku", Gjinnazi "Remzi Ademaj", dhe IAAP "Ymer Prizreni". Kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar i të lartcekurve, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit, mëditjeve, si dhe për shpenzime të paparashikuara për të lartcekurit, konform, akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurve,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 202/26 Dt. 05.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 44, lidhur me nenin 49 të Ligjit nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 20/2016), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2024 për Administratë të Hapur në Komuna dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Grupit Punues

1. Formohet dhe emërohet Grupi Punues për organizimin dhe planifikimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2027 dhe parashikimet për vitin 2028-2029 në Komunën e Prizrenit. Anëtarë të këtij Grupi Punues, emërohen:
 - 1.1. Levent Bush,.....kryesues i grupit,
 - 1.2. Lulzim Sulejmani,..... zv. kryesues i grupit,
 - 1.3. Gjafer Ponik,.....anëtar, procesmbajtës,
 - 1.4. Ymer Berisha,.....anëtar,
 - 1.5. Halil Lika,.....anëtar,
 - 1.6. Fisnik Minci,.....anëtar.
 - 1.7. Arbër Krasniqi,.....anëtar,
 - 1.8. Alban Krasniqi,.....anëtar,
 - 1.9. Arlinda Rama,.....anëtare,
 - 1.10. Dafina Ukallo,anëtare,
 - 1.11. Shpejtim Rramanaj,.....anëtar,
 - 1.12. Haziz Krasniqi,.....anëtar,
 - 1.13. Besarta Caka,.....anëtare.
2. Detyrat e Grupit Punues të emëruar si në pikën 1 të këtij vendimi ndër të tjera janë edhe:
 - 2.1. Identifikimi i grupeve të qytetarëve përmes përdorimit të bazës së të dhënave komunale të grupeve të interesit, përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe buxhetin vjetor të Komunës së Prizrenit, duke përfshirë në mes të tjerash përcaktimin e numrit të dëgjimeve buxhetore, vendit dhe kohës, etj., përgatit materialet që janë të nevojshme gjatë dëgjimeve buxhetore, si: ftesa të personalizuara, (nëse konsiderohet e nevojshme) apo ato që

publikohen në ueb faqe e rrjete sociale të Komunës, modelin e procesverbalit të takimit, listën e pjesëmarrësve, etj.,. Përgatit informacione për buxhetin që do ti prezantohen qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore (përfshirë buxhetin në dispozicion për projekte të reja), në një format të vizualizuar dhe lehtë të kuptueshëm për qytetarët.

- 2.2. Prezantimin e informacioneve të buxhetit (me theks të veçantë në paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët për projekte të reja nga kategoria e investimeve kapitale), ndarja e listave të pjesëmarrësve për nënshkrim, mbajtja e procesverbaleve të takimit, moderimi dhe fasilitimi/lehtësimi i dëgjimit buxhetor (me theks të veçantë në nxitjen e diskutimit dhe pranimin e ideve dhe kërkesave nga qytetarët, e po ashtu në nxitjen e validimit të kërkesave të qytetarëve nga komuniteti i pranishëm në dëgjim buxhetor, sidomos atyre që në bazë të argumentimit konsiderohen se janë prioritare dhe urgjente për tu realizuar).
 - 2.3. Përpilimin e kriterëve/arsyeve për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve dhe kategorizimit e prioritizimit për pranimin dhe refuzimin e tyre, shqyrtimin e të gjitha kërkesave të pranura gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të tjera që pranohen me shkrim (rrjete sociale, email, ueb faqe) apo forma të tjera si takime të rregullta me Kryetarin apo të ngjashme, hartimin e një raporti të detajuar të konsultimeve publike ku evidentohen dhe elaborohen të gjitha kërkesat e pranura të qytetarëve dhe jo vetëm ato të pranura fizikisht gjatë dëgjimeve buxhetore, publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës dhe sipas kërkesave dhe afateve kohore të Udhëzimit Administrativ për Administratë të hapur.
3. Obligohet Grupi Punues dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Grupit Punues,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 203/26 Dt. 05.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e realizimit të projektit: “Furnizim me inventar për zyre për nevojat e Komunës së Prizrenit”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Administratës – pozicioni mallra e shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 204/26 Dt. 05.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e realizimit të projektit: “Mirëmbajtja e Komplekseve Memoriale në Komunën e Prizrenit”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Administratës – pozicioni mallra e shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 212/26 Dt. 12.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, të nenit 8 dhe 19 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për përgatitjen e konkursit, caktimin e kriterëve, shqyrtimin e aplikacioneve dhe përzgjedhjen e studentëve përfitues të bursave të studentëve për vitin akademik 2025/2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Atila Arzuallxhiu,
 - 1.2. Xhafer Ponik,
 - 1.3. Igbalka Rama,
 - 1.4. Ferdi Kovaç, (anëtarë rezervë).
2. Detyrat e Komisionit do të jenë: të përgatisë konkursin, caktimin e kriterëve, shqyrtimin e aplikacioneve dhe të bëjë përzgjedhjen e studentëve përfitues të bursave studentore për vitin akademik 2025/2026.
3. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Komisioni dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Komisionit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 213/26 Dt. 12.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, datës 15.10.2008, të nenit 10 dhe 19 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruara ndaj listës së përfituesve të bursave komunale, të publikuara nga Komisioni që ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave (aplikacioneve) dhe ndarjen e bursave për studentët, për vitin akademik 2025/2026. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Islam Osmankaj,
 - 1.2. Haxhere Gavazaj,
 - 1.3. Zani Vula,
 - 1.4. Nexhat Maçkaj, (anëtar rezervë).
2. Komisioni i përberë si në pikën 1 të këtij Vendimi, në mbledhjen e tij të parë do të zgjedhë kryesuesin e komisionit.
3. Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me konkursin e shpallur për ndarjen e bursave dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit e këtij Komisioni për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Председник Општине
Belediye Başkanı

01 Nr. 211/26 Dt. 12.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 7 dhe 18 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e hapjes së konkursit për ndarjen e bursave studentore

1. Lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2025/2026 për studentët nga Komuna e Prizrenit.
2. Për studentët e lartcekur, si në pikën 1 të këtij Vendimi, lejohet shpallja e konkursit për ndarjen e 250 bursave për studentë.
3. Shuma e përgjithshme që lejohet për këtë qëllim, është në vlerë prej 175.000 € (njëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë euro) për bursa të studentëve përkatësisht 700 € (shtatëqind euro) për një student.
4. Shuma e lejuar, si në pikën 3 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı



01 Nr. 215/26 Dt. 12.05.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” në Prizren, për lejimin e udhëtimit zyrtar të: Alban Krasniqi-aktor, Hajat Toçilla-aktore, Valmira Hoti Ramadani-aktore, Beslidhje Bytyqi-aktore, Burim Mustafa –Ud. drejtor i TQ “Bekim Fehmiu”, Fikrim Menekshe-driçues, Flamur Krasniqi-tonist, Vjollca Hoxhaj-gardarobiere dhe Arben Rashkaj-rekuiziter, me qëllim të realizimit (prezantimit) të shfaqjes teatrore “In Human”, në Teatrin Maladype/Mettrin Art’s Center, nga data 14 maj 2026 deri me 18 maj 2026, në Bank të Republikës së Hungarisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, TQ “Bekim Fehmiu” dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Teatrit të Qytetit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 246/26 Dt. 12.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi


Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-564,3 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve financiare

- Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e pjesëmarrjes së Komunës së Prizrenit-DTZHE në Aktivitetin “Muza Fashion Fair”, i cili mbahet nga data 16 maj 2026 deri me 18 maj 2026, në Tiranë, Republika e Shqipërisë, si dhe mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në këtë aktivitet. Kështu që, i lejohet Komunës së Prizrenit- DTZHE, i lejohet pjesëmarrja në këtë aktivitet dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të pjesëmarrjes, lejohen mjetet financiare për:
 - Pagesën e hapësirës për pjesëmarrje në kompanin “Muza Event” në shumën prej 1,280.00 € (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë),
 - Shërbimet dhe pajisjet e nevojshme, në shumën prej 800.00 € (tetëqind euro).
- Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
- Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 217/26 Dt. 12.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Grantëve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 52631, datë 04.05.2026, të Nergjivan Mustafa Xhabalit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 52631, datë 04.05.2026, e Nergjivan Mustafa Xhabalit, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve lidhur me pjesëmarrjen e nxënësit Orikum Xhabalit, në Finalen Ndërkombëtare të Gjuhës Angleze, e cila mbahet në Itali, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve që lidhen me udhëtimin, akomodimin, etj., lejohen mjetet financiare në shumën prej 500.00 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 219/26 Dt. 14.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në ftesën e Shoqatës së Biznesmenëve dhe Miqësisë Turke-Kosovare (TUKIAD), për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ajlin Shishko Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për pjesëmarrje në Panairin Ndërkombëtar për Industrinë e Tekstilit, që mbahet në Porto të Portugalisë, nga data 19 maj 2026 deri me 22 maj 2026, kështu që, për këtë qëllim lejohen udhëtimi zyrtar, pagesa e mëditjeve, si dhe mbulimi i shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurën, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurës,
 - Arkivës së Kryetarit.



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 218/26 Dt. 14.05.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-300 nr. 56503 datë 13.05.2026 të Faik Bamja, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

